



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

VENDIM

Nr. 170/1, Datë 15.11.2019

“Mbi korigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr. 170, datë 26.06.2019”

Sot më datë 15.11.2019, trupi gjykues, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

“1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij”*,

u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Alma Faskaj për korigjimin e gabimeve materiale në vendimin e subjektit të rivlerësimit Luan Hasneziri.

Lidhur me arsyet e pranimit të korigjimit të vendimit, pas të cilit arrihet në konkluzion se, në vendimin nr. 170 datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në dispozitivin e vendimit togëfjalëshi. ” *prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.* ” duhet të të zëvendësohen me togëfjalëshin “gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.” dhe mbiemri i subjektit nga “*Hazneziri*” të zëvendësohet me “*Hasneziri*”

Trupa gjyqese pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimeve materiale, në faqen nr. 20 të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit z. Luan Hasneziri;

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 170 datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:

a. Në pjesën e dispozitivit të vendimit :

1) Mbiemri i subjektit nga “*Hazneziri*” duhet të zëvendësohet me “*Hasneziri*”

2) Togëfjalëshi.” *prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.*” duhet të të zëvendësohet me togëfjalëshin “*gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda*”.

2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.

3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjyqës

Suela Zhegu
Kryesuese

Alma Faskaj
Relatore

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta